

Prishtinë, 20 shkurt 2015
Kodi i ZRRE-së: V_711_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
Dispozitat e Nenit 22 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit Operativ të datës 13 janar 2015,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET amendamenti i dokumentit “Kodi Operativ” të KOSTT Sh.a.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.12.2014 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit Operativ të harmonizuar me Doracakun e Operimeve ENTSO-E (*European Network of Transmission System Operators for Electricity*). Në këtë kuadër janë bërë edhe disa përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.
- Pas këtyre zhvillimeve, KQKO ka amendamentuar dokumentin në harmoni me ndryshimet, dhe me datë 13.01.2015 ka bërë kërkesë zyrtare në ZRRE për Arovimin e amendamentimit të Kodit Operativ.
- Pas vlerësimit të kërkesës, ZRRE ka parë të arsyeshme që të aprovojë amendamentimin e Kodit Operativ.
- Të gjitha dispozitat tjera të Kodit Operativ do të mbesin në fuqi.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.





III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT-it.


Këshillë juridike: Palët e pakënaqura me këtë Vendim mund të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti me pikat e Amandamentuara të Kodit Operativ dhe Kodi Operativ i amandamentuar.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar